




REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLËS SË PARË SHKODËR

Adresa: L. Qemal Stafa, Rr. Don Bosko, Tel&Fax +355 22 21 21 21 dhe +22 21 21 22

Nr. Rregj.Them. 351/1678  
Dt. Rregj. 22.12.2014

Nr. Vendimi 451  
Dt. Vendimi 28.05.2015



V E N D I M

“NE EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata Administrative e Shkallës së parë Shkodër e përbërë nga:

**Valbona DURRAJ – gjyqtare**

Asistuar nga sekretare seance Albana Palaj, sot me 28.05.2015, ora 10.30 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore çështjen administrative me nr.Rregj.Them.351/1678 datë 22.12.2014 që l përket palëve ndërgjyqëse:

**PADITËS :** Genti Bushati i biri i Syrri dhe Rudina ,i datelindjes 16.02.1975, lindur ne Shkoder dhe banues ne L."Perash",Bulevardi "Mehmet Pash Plaku",Nr .6, Shkoder, me aktivitet si Person Fizik " Permbarues Gjyqësore Privat " Nr Certificate 101 te dates Maj - 2012 me Nipt - L 26717001 B,me adrese ushtrimi aktiviteti:Rruga "Don Bosco" ,Perballe Gjykares Rrethit Gjyqësore Shkoder.

**TE PADITUR:** Drejtorja Rajonale e Tatimeve Shkoder( perfaqsuar nga znj. Siriana Bakushi).  
Drejtorja e Apelimit Tatimor,prane Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve Tirane ( perfaqsuar nga znj. Siriana Bakushi).

**OBJEKTI:** Anullimin e Aktit Administrativ "Njoftim Vleresimit per Detyrimet Tatimore Nr 6299 / prot,date 13 / 08 / 2014 te Drejtorise Rajonale Tatimore Shkoder.  
Anullimin e Vendimit te Drejtorise se Apelit Tatimor Nr 23842/l date 27-11-2014.

**BAZA  
LIGJORE:** Nenet 3,10,11,15,16,17/a,c,,18,35 te Ligjit Nr.49/2012 "Per organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative,neni 32 K.P.Civile, neni 109 i Ligjit nr.9920 date 19.05.2008," Per procedurat tatimore ne R. Sh-se".

Gjykata në përfundim të hetimit gjyqësor, pasi administroi provat shkresore të paraqitura, dhe pasi dëgjoji paditesin/ i cili u shpreh për pranimin e kërkesë padisë,

perfaqsesen e palës së paditur të cilët kërkojnë rrezimin e kerkese padise si të pambështetur në ligj dhe prova, shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi:

**VËREN se:**

Paditesi Genti Bushati është i drejtuar Gjykatës Administrative të Shkalës së Parë Shkoder me kerkese padi kunder anes se paditur 1) Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve Tirane, Drejtoria e Apelit Tatimor Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkoder, me objekt;

"Anullimin e aktit administrativ, njoftim vleresimit per detyrimet tatimore nr.6299 prot date 13.08.2014 te Drejtorise Rajonale te Tatimeve Shkoder.

Anullimin e vendimit te Drejtorise se Apelit Tatimor nr.23842/1 prot date 27.11.2014".

***Rrethanat e ceshtjes;***

Pala paditese me date 03-07-2014 ka deklaruar Sigurimet Shoqerore On-line.

Gjate ketij procesi ka konstatuar te aktivizuar dhe TAP-in ( Tatim mbi te ardhurat nga Punesimi). Te nesermen ma date 04-07-2014 eshte drejtuar prane Sherbimit ndaj Tatimpaguesit ku eshte njoftuar verbalisht se Tap-i, ishte aktivizuar qe me date 28-01-2013 ( **njoftim te cilin nuk e ka marre asnjehere** ).

Ka deklaruar TAP-in me vlera Zero me date 25-07-2014 per Periudhat 2013/03 ; 2013/06 2013/09 ;2013/12 ;2014 /03.

Me date 15-08-2014 kam marre Njoftim - **Vleresimin me Nr 6299 /Prot date 13.08.2014** nga Drejtoria Tatimore Shkoder, per gjobat per deklarim te vonuar te cilat jane;

**Shuma e gjobave eshte 50,000 leke ,Per Deklarim te Vonuar.**

- 1- TAP 2013/03 10,000 leke GJOBA
- 2- TAP 2013/06 10,000 leke GJOBA
- 3- TAP 2013 /09 10,000 leke GJOBA
- 4- TAP 2013/12 10,000 leke GJOBA
- 5- TAP 2014/03 10,000 leke GJOBA.

Ne keto kushte bazuar ne Ligji Nr. 9920, date 19.5.2008 "Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise", te ndryshuar. Neni 106 , jam drejtuar dhe kam depozituar ne Drejtorine e Apelit Tatimor Tirane ankimin Nr 169 / Prot date 02-09-2014 ku kam kerkuar nga ana e tyre te me hiqet kjo gjobe e pa drejte dhe e pa legjitimuar, per arsye te mosnjoftimit te tij ne rruge zyrtare .

Me Vendimin Nr 23842 /1 date 27-11-2014 Drejtoria e Apelit Tatimor Tirane ka vendosur: Lenien ne fuqi te aktit administrativ, objekt ankimi "Njoftim Vleresimit per Detyrimet Tatimore Nr 6299 / prot,date 13 / 08 / 2014 te Drejtorise Rajonale Tatimore Shkoder.

***Ne gjykim paditesi paraqet se :***

Nuk jam vene ne dijeni asnjehere nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve qe eshte bere aktivizimi i TAP-it , detyre te cilen e ka kjo drejtori te njoftoje cdo tatim.paguaes , kete e vertetoj me shkresen e dt 19-08-2014 ku kam paraqitur Kerkese Drejtorise

Rajonale te Tatimeve - Dega Shkoder. Drejtorise se Sherbimit ndaj Tatim Paguesit per tu pajisur me nje kopje te Njoftimit per Aktivizimin e TAP-it.

Gjithashtu me date 01.09.2014 kam marre dhe konferme nga Posta - Sh.A Shkoder qe nje objekt i tille nuk ka ardhur ne adresen time me date 28-01-2013 apo ndonje dite me vone.

Kjo verteton katerciperisht qe une nuk jam informuar per kete aktivizim dhe ne kushte te tilla ka qene e pamundur kryerja e veprimeve persa I perket depozitimit te TAP-it prane DRT Dega Shkoder.

Gjithashtu une jam Person Fizik i Vetpunesuar ,pa Punemarres. Aktiviteti im si Permbarues Gjyqesore Privat eshte i licensuar nga Ministria e Drejtesise si Person Fizik dhe jo si Shoqeri Permbarimore.

Une nuk mund te punesoj njerez pa licensen e Ministrise. Nuk mund te delegoj kompetenca ne kryerjen e veprimeve Permbarimore , personave te tjere, pra cdo veprim kryhet nga une vete Personalisht ,prandaj nuk kam punemarres .

### **Ana e paditur parashtroi se :**

Mosdeklarimi ne afat i detyrimit tatimor apo kontributit perben shkelje administrative tatimore dhe penalizohet me gjobe ne zbatim te nenit 113 "mosdeklarimi ne afat" te ligjit nr.9920 dt. 19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise" i ndryshuar, Udhezimit nr.24 date 02.09.2008 per zbatimin e ketij ligji. Neni 113 i ketij ligji "Mos deklarimi ne afat"shpreh :

Tatimpaguesi, i cili nuk dorezon deklaralen tatimore ne afat, denohet me gjobe me 10 000 leke per cdo deklarate tatimore te padorezuar.

Subjekti i eshte drejtuar me nje kerkese per apelim Drejtorise se Apelimat Tatimor, prane Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve Tirane duke kerkuar, persa i perket ketij njoftim vleresimi, anulimin e gjobes.

Gjobat e vendosura per shkelje tatimore administrative, mund te hiqen teresisht ose pjeserisht vetem ne zbatim te kerkesave te nenit 111, pika 4 te ligjit nr.9920 date 19.05.2008 'Per Procedurat Tatimore ne R.SH' dhe pikes 111.4.1 te udhezimit nr.24 date 02.09.2008 per zbatimin e ketij ligji.

Per pasoje gjoba e vene eshte ne perputhje me kerkesat e nenit 113 te ligjit 9920/2008 dhe se kerkese padia duhet rrezuar.

### **Gjykata veren se;**

Kerkimi I paditesit eshte I mbeshtetur ne prova per faktin e vetem se administrata tatimore ka detyrimin ligjore qe te beje njoftimin e cdo veprimi te saj ndaj tatim paguesit, dhe se ne rastin e varur per gjykim rezulton se subjekti tatimpagues nuk eshte njoftuar per aktivizimin e TAP-it dhe per pasoje vonesat ne deklarim nuk mund ti faturohen tatim paguesit me justifikimin e zbatimit te saksioneve qe parashikon neni 113 I ligjit 9920/2008 dhe udhezimi nr.24 date 02.09.2008 per zbatimin e ketij ligji.

Neni 113 i ketij ligji "**Mos deklarimi ne afat**"shpreh :

*Tatimpaguesi, i cili nuk dorezon deklaralen tatimore ne afat, denohet me gjobe me 10 000 leke per qdo deklarate tatimore te padorezuar.*

Ne gjykim u provua se eshte vete mosveprimi I anes se paditur qe ka sjelle vonesat ne deklarim ,e provuar kjo dhe me konferme nga Posta - Sh.A Shkoder qe nje objekt i tille nuk I eshte vene ne dispozicion pales paditese

Per pasoje gjykata e gjene kerkimin te mbeshtetur ne prova dhe ligje dhe vendose pranimin e kerkese padise,prandaj


### PER KETO ARSYE

Gjykata, bazuar ne nenin 40, 41, /42 te ligjit nr 49/2012 "Per organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarreveshjeve administrative"

### VENDOSI

- Pranimin e kerkese-padise.
  - Anullimin e Aktit Administrativ "Njoftim Vleresimit per Detyrimet Tatimore Nr 6299 / prot,date 13 / 08 / 2014 te Drejtorise Rajonale Tatimore Shkoder.
  - Anullimin e Vendimit te Drejtorise se Apelit Tatimor Nr 23842/I date 27-11-2014.
  - Shpenzimet gjyqsore ( vlera e taksës së kërkesë padisë në masën 3000)lekë ne ngarkim te anes se paditur.
  - Ky vendim perben titull ekzekutiv dhe ekzekutohet menjëherë.
  - Kunder vendimit nuk lejohet ankim.
- Shkoder me date 28.05.2015**

**SEKRETARE SEANCE**  
Albana PALAJ



**GJYQTARE**  
Valbona DURRAJ

